

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/08/21;
Datë: 23.08.2021 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Muharrem Krasniqi - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: mbledhja e tetë-(2021) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 31.08.2021, ora 14⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrje -shirjeve në komunën e Junikut
3. Kërkesë për Plotëm-ndryshimin e vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e programit trevjeçar komunal për banim;
4. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2022/04 të Ministrisë së Financave;
5. Informatë lidhur me perfundimin e vitit shkollor 2020/21 dhe përgaditjet për vitin e ri shkollor 2021/2022 ;
6. Të ndryshme



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-07/21
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	29.07.2021
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së shtatë (7) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2021 me datë: 29.07.2021, në ora 14:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Muharrem Krasniqi, i cili në fillim përshëndeti, Anëtarët e Kuvendit Komunal, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

Mbledhja u organizua duke respektuar udhëzimet e IKSHPK-së.

Anëtarët prezent

- | | |
|--------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Muharrem Krasniqi - Kryesues, AAK | 11. Zenel Maloku - Anëtar, i pavarur |
| 2. Behare Qestaj - Anëtare, AAK | 12. Gjyle Miroci - Anëtare, LVV |
| 3. Sindije Idrizi - Anëtare, AAK | 13. Zeqë Hebibi - Anëtar, LDK |
| 4. Betim Gacaferi - Anëtar, AAK | 14. Zejnep Gaxherri - Anëtare, LDK |
| 5. Albert Gjocaj - Anëtar, AAK | |
| 6. Xhemë Tofaj - Anëtar, AAK | Mungoi: Dardane Shala - Anëtare, AAK |
| 7. Tahir Isufaj - Anëtar, LDK | |
| 8. Blerim Gacaferi - Anëtar, PDK | |
| 9. Edona Shehu - Anëtare, LDK | |
| 10. Florim Shala - Anëtar, LVV | |

z. Muharrem Krasniqi: Kryesuesi fillimisht, njoftoj se znj. Erleta Isufaj ka dhënë dorëheqje të parevokueshme, ku kërkesa e saj është dërguar në Komisionin Komunal Zgjedhor dhe pastaj ata e kanë përcjellur në Prishtinë ku është pranuar dorëheqja e saj dhe menjëherë kanë caktuar anëtarën tjetër e cila në pikën e parë do të jetë dhënia e betimit të saj.

znj. Zejnep Gaxherri: E dha betimin e saj si anëtare e re e asamblesë komunale në Komunën e Junikut.

Rendi i ditës

1. Dhënja e betimit të anëtarës së re të asamblesë komunale në Komunën e Junikut, znj. Zejnep Gaxherri (LDK).
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Kërkesë për ndarjen e çmimit “ Din Mehmeti ” mësimdhënësve, zyrtarëve dhe punëtorëve veteranë të arsimit në Komunën e Junikut,
4. Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të projekt-rregullores për Menaxhimin e Varrezave Komunale,
5. Raportin gjashtë mujor financiar Janar-Qershor 2021,
6. Kërkesë për hartimin e Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë,
7. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: E hapi diskutimin sa i përket rendit të ditës.

znj. Behare Qestaj: Ne pajtohemi me këto pika të rendit të ditës.

z. Tahir Isufaj: Kishte vërejtje në pikën e tretë (3): Kërkesë për ndarjen e çmimit “ Din Mehmeti ”.

z. Muharrem Krasniqi: E hedhi në votim këtë rend të ditës. **Nga 12 prezent, për 9, kundër 3, asnjë kundër, kalon.**

Pika e dytë e rendit të ditës

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z. Muharrem Krasniqi: Pasi nuk kishte vërejtje rreth procesverbalit, Kryesuesi e hedhi në votim. **Nga 12 prezent, 9 ishin për, kundër nuk kishte, 3 abstenime, kalon.**

Pika e tretë e rendit të ditës

3. Kërkesë për ndarjen e çmimit “ Din Mehmeti ” mesimdhënësve, zyrtarëve dhe punëtorëve veteranë të arsimit në Komunën e Junikut,

z. Muharrem Krasniqi: Pasi që nuk i kishin emrat, Kryesuesi propozoj që kjo pikë të shtyhet për më vonë për shkak teknike derisa të vijnë emrat që kanë për t'iu ndarë ai çmim. Kështu, kaluan në pikën e katërt.

Më vonë vazhduan me këtë pikë, duke i dhënë fjalën Drejtorit z. Fatos Shala.

z. Fatos Shala: Kjo nuk është hera e parë që po ndahen këto çmime, dëshira është që edhe mesimdhënësve të cilët kanë dalë në pension t'iu japin mirënjohje. Për më shumë, kisha pasë dëshirë të merrë fjalën z. Arton Krasniqi.

z. Arton Krasniqi: Çmimi “ Din Mehmeti ” ndahet çdo katër (4) vite, në listë janë përfshirë mesimdhënësit të cilët kanë dalë në pension nga viti 2017 dhe personalitete që kanë punuar në personel arsimor, administrativ dhe teknik me kohë të caktuar. Në këtë listë janë përfshirë 41 personalitete, 16 janë post-mortum.

z. Zenel Maloku: Kishte propozim që të hiqen nga lista disa personalitete që nuk e meritojnë këtë çmim të “ Din Mehmetit ”.

z. Muharrem Krasniqi: Njoftoj se tani në sallë janë prezent 13 anëtarë, pasi që znj. Edona Shehu erdhi.

Kryesuesi, shtoj se sa për informacion, çmimi do të ndahet vetëm për mesimdhënës, njerëzit që kanë punuar në arsim. Tutje iu dha fjalën në emër të grupit.

znj. Behare Qestaj: Sa i përket grupit tonë ne jemi të pajtimit për këtë listë, për kontributin e tyre që kanë japur në arsim.

z. Muharrem Krasniqi: Njoftoj se tani janë prezent 14 anëtarë sepse na u është bashkangjitur edhe Florim Shala. Dhe e hedhi në votim këtë pikë, ku nga 14 anëtarë prezent, për ishin 12, kundër 1, abstenim 1, kalon.

Pika e katërt e rendit të ditës

4. Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të projekt-rregullores për Menaxhimin e Varrezave Komunale,

z. Muharrem Krasniqi: Fjala për Drejtoreshën e Administratës.

znj. Leonita Jasiqi: Përshëndeti gjithë të pranishmit, ashtu siç e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje, Statutin e Komunës dhe vendimin e Kryetarit të Komunës është themeluar Komisioni për hartimin e rregullores për Menaxhimin e Varrezave Komunale. Grupi Punues është takuar disa herë deri në hartimin e rregullores, gjatë punës e kanë parë të arsyeshme që pjesë e këtij grupi punues të jenë edhe anëtarë të Bashkësive Fetare. Pasi ata ishin pjesë e grupit punues prapë kemi hartuar një draft rregullore të cilën ju e keni pasur në lexim të parë. Rregullorja pothuajse ka mbetur e njëjtë, i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore që janë të parapara me ligj. Gjatë diskutimit publik nuk kemi pasur

asnjë sugjerim apo koment, kështu kemi konsideruar se rregullorja mbetet e tillë, e kemi sjellë në lexim të dytë, besoj që do e merr miratimin nga ana e juaj.

znj. Behare Qestaj: Meqënëse kjo rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore siç e ceku Drejtoresha, ne si grup pajtohemi.

z. Tahir Isufaj: Ne do të abstenojmë. Dhe pyeti Drejtoreshën se sa vendvarrime janë në Junik.

znj. Leonita Jasiqi: Shtoj, takimet që kemi pasur me OSBE-në për hartimin e kësaj rregullore, ku kanë marrur pjesë të gjitha Komunitet dhe Bashkësitë Fetare, ku ne për herë të parë kemi hartuar një rregullore të tillë, komunitet tjera kanë qenë nga viti 2001-2002 dhe rregullorja jonë është marrur si shembull. Dhe për pyetjen e z. Tahir Isufaj kërkoj që t'i jepet fjala z. Hasan Krasniqi-t.

z. Hasan Krasniqi: Në rregullore janë kategoritë e vendvarrimeve, ato formale dhe joformale, kjo i shpjegon shumë mirë, ju e dini rregullorët nuk merren me çështje të vogla, me numra të varrezave.

z. Zenel Maloku: Kam ndëgju që e keni ndarë një pjesë për varrezat e veteranëve, deshta të di a i keni ndarë dhe për dëshmorë.

z. Hasan Krasniqi: Po, është e paraparë kategoria e parë në të cilën bëjnë pjesë heronjtë dhe dëshmorët. Ne jemi afër nënshkrimit të kontratës për ndërtimin e varrezave të dëshmorëve, shpejtë do të finalizohet dhe është një projekt i mirë.

z. Muharrem Krasniqi: E hedhi në votim, **nga 12 prezent, 9 për, kundër nuk ka, 3 abstenime, kalon.**

Pika e pestë e rendit të ditës

5. Raportin gjashtë mujor financiar Janar-Qershor 2021,

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjona: Përshëndeti të gjithë dhe prezantoi raportin gjashtë mujor financiar Janar-Qershor 2021.

znj. Behare Qestaj: Si grup nuk kishin ndonjë vërejtje.

z. Tahir Isufaj: Në emër të grupit kemi vërejtje në investimet kapitale, për shembull: Rehabilitimi i rrugëve lokale (10,000.00 €), Asfaltimi i rrugëve lokale (20,000.00 €), Hapja e rrugëve fushore (10,000.00 €), që janë bashkë (40,000.00 €), pyeti cilat janë ato rrugë dhe shtojë se nga viti 2018 shumë pak investime kapitale.

z. Hasan Krasniqi: Asfaltimi i rrugëve lokale është projekt i drejtorisë time, ka hala shumë punë në këtë projekt, kemi ndarë mjete shtesë. Ato rrugë janë: rruga e varrezave, Malok, Qendër, Berishë, etj. Ndërsa sa i përket Rehabilitimit të rrugëve lokale është bërë shumë punë duke ditur edhe dëmet nga vërshimet, kurse për rrugët fushore, është hapur rruga në Bjeshkë i cili është projekt 2 vjeçar.

z. Zeqë Hebibi: A mundesh me na tregu saktë a është gropa e erenikut në territor të Komunës së Junikut.

z. Tahir Isufaj: Pyeti se kush e menaxhon Parkun Nacional.

z. Hasan Krasniqi: Ne kemi kufi zyrtar, i kemi 7,777.00 m². E kemi obligim ta mbrojmë atë territor. Ndërsa Parkun Nacional e menaxhon Drejtoria e Parkut.

z. Zeqë Hebibi: Pyeti rreth projektit Rregullimi i hapësirave sportive që është (10,000.00 €), a bën ta dimë se ku është.

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaj: Ky projekt nuk është i shfrytëzuar akoma, ky është vetëm buxheti i ndarë në vlerë (10,000.00 €) për Rregullimin e hapësirave sportive, rekreative në shkollën fillore. Pritet që të vazhdojnë punimet por nuk ka shpenzim për periudhën Janar-Qershor.

z. Hasan Krasniqi: Ka me u punu në Bajraktar, Krasniqi dhe Miroc. Kanë për t'u vendosur disa lojëra, ulëse, mure mbrojtëse, është një projekt i mire dhe aty ku kemi gjetur hapësira kemi planifikuar kënde të lojërave. Në Krasniqi fillojmë nga xhamia e poshtë, kemi menduar aty ku është frekuentimi më i madhë i fëmijëve.

z. Zenel Maloku: Po më intereson si territor e përmendi Drejtori, Luku i gjatë a është territor i Junikut apo i Vokshit.

z. Hasan Krasniqi: Kufiri zyrtar i Komunës së Junikut nuk e definon që ajo pjesë a shfrytëzohet nga banorët e Junikut apo të një rajoni tjetër.

z. Tahir Isufaj: Pyeti si ka mundësi që prej Buxhetit që e ndan Qeveria e Kosoves të shkojnë 81.79% vetëm për paga dhe medijtje.

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaj: Më herët kemi qenë pilot njësi, tani janë 163 punëtorë që paguhën nga buxheti. Nëse duam të funksionojmë si Komunë duhet t'i plotësojmë vendet e punës të caktuara me ligj.

z. Muharrem Krasniqi: Kjo pikë nuk votohet. Kalojnë në pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Pika e gjashtë e rendit të ditës

6. Kërkesë për hartimin e Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë,

z. Hasan Krasniqi: Është obligim ligjor dhe kërkesë shumë e madhe e shoqatave dhe organizatave që po na monitorojnë për të pasur një plan për ruajtjen e trashëgimisë, kemi bërë kërkesë jemi pak me vonesë dhe nuk e di sa sa mundet ky ekzekutiv t'i miratoj të gjitha leximet.

z. Zeqë Hebibi: Përmendi Valavicën që është më mirë t'i jepet në shfrytëzim diku që merret me kulturë të vjetër.

z. Muharrem Krasniqi: Tutje e hedhi në votim këtë pikë, nga 14 prezent, 8 ishin për dhe 4 kundër, kalon.

Pika e shtatë e rendit të ditës

7. Të ndryshme.

znj. Leonita Jasiqi: Jepi përgjigje rreth Kodit Etik, në njërën nga mbledhjet e fundit të vitit 2020 anëtarët e Kuvendit e kanë miratuar kodin e etikës, sipas nenit 33 pika 6 Kryetari ka të drejtën e themelimit të këtij komisioni i cili do të themelohet, deri më tani nuk kemi pasur asnjë shkelje të kodit të etikës apo ndonjë vërejtje.

z. Muharrem Krasniqi: Kërkon që sa më shpejtë të formohet ky komision në mënyrë që njerëzit të kenë një adresë se ku të ankohen për ndonjë shkelje.

znj. Leonita Jasiqi: Edhe pa formimin e këtij komisioni, gjithmonë është formuar një komision për shqyrtimin e ankesave. Sa i përket punësimit është një projekt me prioritet i Komunës së Junikut për ofrimin e shërbimeve që ofrohet nga një kompani e kontraktuar nga Komuna.

z. Muharrem Krasniqi: Kryesuesi i Kuvendit i falenderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.


Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:05

Procesmbajtëse:

znj. Fitore Velijaj

Kryesues i Kuvendit:

z. Muharrem Krasniqi



RËPUBLIKA E KOSOVËS – RËPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIK OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

DATË/A:	03.08.2021
REFERENC-Ë:	05.Nr.6/2021
PËR/ZA/TO:	DPBT- Isuf Cikaqi
CC:	Agron Kuçi - Kryetar
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Leonard Ljolluni - Drejtor për Zhvillim Ekonomik
NGA/OD/FROM:	Komisioni Komunal për korrje-shirje
TEMA/OBJEKTAT/SUBJECT:	Raporti përfundimtar për fustatën e korrje-shirjeve 2021

Te nderuar/e

Komisioni Komunal i emëruar nga Kryetari i komunës së Junikut z. Agron Kuçi për monitorimin dhe realizimin e korrje-shirjeve të drithërave të bardha për vitin 2021 me këtë përbëje:

Komisioni:

- Ali Gacaferi
- Shkelzen Shehu
- Isuf Balaj
- Shpejtim Kuçi

kryetar
anëtarë
anëtarë
anëtarë

Drejtoria për zhvillim ekonomik - duke u bazuar në programin e punës për monitorimin dhe vëzhgimin e procesit të korrje-shirjes ka bere kërkesë Kryetarit të komunës së Junikut z. Agron Kuçi për formimin e komisionit profesional për monitorimin e procesit të korrje-shirjes ku gjatë kësaj kohe komisioni profesional vazhdimisht ka qenë në teren duke u njoftuar me vështirësitë dhe problemet e fermerëve dhe auto kombajnerëve që ballafaqohen në realizimin e procesit të korrje-shirjes njëkohësisht duke ju ofruar mbështetje profesionale për zgjedhjen e këtyre problemeve dhe vështirësive të mundshme.

Në Komunën e Junikut korrja –shirja ka filluar me datën **09.07.2021** edhe atë ne Bramatoqe, ku vegjetacioni është më i hershem se ne pjesët tjera të Komunës, po me këtë date mbas ditë Junikut me rrethin e ka përfshirë një mot shume i lig i përcjellur me era te forta dhe breshër, ku është ndërprere procesi i korrje shirjeve për disa dite. Më date: **20.07.2021** ka përfunduar procesi i korrje shirjeve.

Është e rëndësishme të ceket se ne këtë operativ kanë marr pjesë 3 autokombajna.

Operativa e korrje-shirjes përkundër disa problemeve të vogla është realizuar ashtu siç është hartuar dhe planifikuar nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik . Vlen te përmendet se Çmimi për një hektar i rekomanduar nga MBPZHR është respektuar nga kombajneret dhe ka qen **90 euro / ha**.

Në bazë të dhënave nga terreni dhe analizave tona në teren rendimenti mesatar në këtë vit ka qenë:

Tabela e 2021:

Nr.	Kultura-sipërfaqet	Rendimenti për 2021
1.	Grurë 45ha	1200 kg/ha
2.	Elb	
3.	Tërshërë	

Problemet të cilat janë paraqitë gjatë korrje-shirjes janë:

- Kushtet jo te mira atmosferike te cilat e kanë zgjat operativen e korrje shirjes
- Zgjedhja e terreneve më të përshtatshme nga auto kombajnerët
- Defekteve ne makinerinë e autokombajnave-prishja e disa pjesëve

Rendimenti te kultura e grurit ka qenë ma i ultë krahasuar me vitin e kaluar për shkak:

- Të kushteve agroklimatike më të pa volitshme krahasuar me vitin e kaluar, gjë që ka ndikuar dukshëm në rendiment, gjatë pranverës ka pasur mungesë te lagështisë dhe netët e ftohta ,plus ne qershore i nxehti afrikan, dhe ne korrik breshri.

Për përfundim të suksesshëm të korrje-shirjeve përkundër kushteve jo te mira meteorologjike kanë ndikuar disa faktorë:


- Prezenca e një autokombajne nga Juniku dhe dy nga Komuna e Gjakovës.
- Prezenca e Komisionit Komunal për monitorim te korrje shirjeve

Vërejtje:

Si komision për korrje-shirje gjatë zhvillimit të këtij operacioni kemi hasur në këto vështirësi :

- Zgjedhja sipas dëshirës e terreneve nga auto kombajnerët,
- Papërshtatshmëria e terreneve për korje në disa pjesë,
- Kushte jo te mira klimatike
- Parcela me sipërfaqe të vogla dhe larg njëra tjetrës gjë që e vështirëson punën e autokombajnave,

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere /
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATE/A:	05.08.2021
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2022/02 për Komuna

Të nderuar,

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2022/02 për Komuna, e cila ofron kufijtë buxhetor për secilën komunë për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të buxheteve komunale për vitin 2022.

Me respekt!

Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Qarkorja Buxhetore 2022/02

1. Qëllimi

Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë Qarkore Buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Dytë Buxhetore 2022/02, ku ofrohen udhëzimet për hartimin e buxhetit për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024 si dhe jepen kufijtë buxhetor final. Këta kufij mund të ndryshojnë varësisht rishikimit të KASH 2022-2024.

2. Kriteret e përgjithshme dhe specifike për përgatitjen e buxhetit

Komunat duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së projektbuxhetit t'i japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioritetëve komunale;
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale;
- Të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore;
- Për të respektuar rregullin fiskal të pagave të paraparë me legjislacionin e financave publike në Kosovë dhe për të liruar presionin mbi buxhetin komunal për paga dhe shtesa, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kërkon nga komunat që të fshijnë numrin e pozitive fiktive (pozita pa mbulesë buxhetore). Numri aktual i të punësuarve (duke përfshirë të punësuarit me pushim pa pagesë dhe të punësuarit që janë në pushim të lehonisë) dhe numri i pozitive që janë në procedurë të rekrutimit duhet të mbesin. Në lidhje me këtë ju lutemi që deri më datë 15 gusht 2021 të dërgoni informatat e punësimit.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2022 dhe projeksionet për vitet 2023-2024 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira buxhetore me fokus në këto çështje:
 - Plotësimin e të dhënave që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe eliminimin e keqklasifikimit të shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga Komunitet analisti buxhetor do të identifikojë keqklasifikime, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largoj nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keqklasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
 - Projektet e propozuara të jenë projekte të përgatitura në përputhje me Manualin e PIP-it dhe Udhëzimin Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale;
 - Projektet e propozuara të jenë të maturuara (projekte të gatshme për zbatim);

- Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në SIMFK;
- Buxhetimi i projekteve kapitale duhet të bëhet në përputhje me **Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale**, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Me këtë rast, komunat pas një analize paraprake duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.

Në vijim të këtij procesi vëmendje e shtuar nga MFPT do t'i jepet zbatimit të rekomandimeve të lartpërmendura. Nëse komunat nuk plotësojnë të dhënat sipas manualit të PIP dhe analizën për çdo projekt-propozim të ri sipas UA për Kriteret Përzgjedhëse si dhe nëse dorëzohet propozim buxheti që përmban keqklasifikim, atëherë MFPT do të marrë masa për korrigjimin e tyre para dorëzimit të projektbuxhetit për vitin 2022 për aprovim në Qeveri.

3. Kufijtë buxhetor për komunat (struktura e shpenzimeve)

Komunat duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetorë të dhënë në tabelat në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2022 dhe për dy vitet në vijim.

Ju lutem të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga rishikimi i KASH 2022-2024.

Gjatë planifikimit të buxhetit për vitet 2022-2024 secila komunë duhet të respektoj strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të lëshuara me këtë qarkore.

Struktura është përgatitur duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2022/01 (politikat e reja dhe në vazhdimësi të aprovuara nga Komisioni i Granteve) si dhe KAB komunal për vitin 2022-2024.

Më poshtë në Tabelat e bashkangjitura është paraqitur struktura e shpenzimeve për vitin 2022-2024.

4. Dorëzimi i propozim-buxhetit komunal

Pas aprovimit të propozim-buxhetit për vitin 2022-2024 nga Kuvendet Komunale, komunat duhet të dorëzojnë atë në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve deri me datë **30 shtator 2021**. Propozim buxheti i aprovuar duhet të përmbajë dokumentet si në vijim:

- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal.
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal 2022-2024,
- Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve 2022-2024,
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2022-2024,
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal 2022-2024,
 - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator,
 - Tabelat e Buxhetimit sipas performancës.

Tabela 1: Struktura e shpenzimeve për vitin 2022

Nr.	Komunat	Nr. i të punësuarve	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej 2022
1	Deçan	880	5,698,340	1,694,536	156,000	160,000	2,940,479	10,649,355
2	Dragash	776	4,830,821	1,063,000	130,000	270,000	3,035,656	9,329,477
3	Ferizaj	2,407	15,960,525	5,529,067	725,686	963,776	10,754,814	33,933,868
4	Fushë Kosovë	776	5,290,000	1,900,000	260,000	455,000	3,751,080	11,656,080
5	Gjakovë	2,252	14,430,000	3,564,341	578,700	600,500	8,643,390	27,816,931
6	Gjilan	2,479	16,199,142	4,727,835	576,800	970,000	6,601,502	29,075,278
7	Glogoc	1,327	8,700,000	2,100,000	298,508	420,000	4,327,583	15,846,091
8	Hani i Elezit	239	1,756,083	385,975	67,700	80,000	470,000	2,759,758
9	Istog	974	6,511,000	1,593,959	202,000	310,000	2,995,040	11,611,999
10	Junik	163	1,154,611	202,780	36,200	50,000	215,000	1,658,591
11	Kaçanik	804	5,289,744	909,423	221,000	300,000	2,473,001	9,193,168
12	Kamenicë	1,189	7,542,413	1,619,200	211,800	343,000	1,354,178	11,070,591
13	Klinë	950	6,460,889	1,308,064	167,000	350,000	3,047,380	11,333,332
14	Leposaviq	569	2,363,643	415,316	64,000	95,000	1,664,956	4,602,915
15	Lipjan	1,526	9,886,000	1,998,000	330,000	766,000	4,613,652	17,593,652
16	Malishevë	1,299	8,591,643	1,729,730	455,000	500,000	4,379,384	15,655,757
17	Mamushë	155	1,160,695	327,000	31,000	40,000	243,345	1,802,040
18	Mitrovicë	1,989	12,482,357	3,330,842	488,008	636,500	4,589,006	21,526,713
19	Novobërdë	351	2,122,675	312,594	70,000	52,900	354,511	2,912,680
20	Obiliq	647	4,350,000	1,288,679	316,675	850,000	5,016,815	11,822,169
21	Pejë	2,250	14,887,342	3,700,000	748,455	531,016	9,429,241	29,296,054
22	Podujevë	1,995	12,470,000	2,650,000	420,000	960,000	6,949,521	23,449,521
23	Prishtinë	4,755	31,300,000	21,198,930	2,200,000	4,786,215	31,184,188	90,669,333
24	Prizren	3,175	21,350,000	8,650,550	1,071,199	1,880,000	16,504,006	49,455,755
25	Rahovec	1,186	7,872,844	1,735,000	270,000	360,000	4,815,816	15,053,660
26	Shtërpçë	517	2,490,000	469,917	82,625	45,000	783,806	3,871,348
27	Shtime	665	4,405,585	1,000,704	210,000	150,000	1,937,740	7,704,029
28	Skenderaj	1,338	8,350,000	1,700,000	200,000	730,000	3,548,788	14,528,788
29	Suharekë	1,316	8,611,766	2,450,000	386,000	490,000	5,182,865	17,120,631
30	Viti	1,161	7,618,305	2,092,704	320,000	360,000	2,678,486	13,069,495
31	Vushtrri	1,601	10,720,000	3,278,239	428,000	657,540	4,779,107	19,862,886
32	Zubin Potok	421	1,530,000	291,000	50,000	91,104	570,901	2,533,005
33	Zveçan	368	1,490,000	305,060	40,000	80,000	400,128	2,315,188
34	Gracanica	591	3,110,760	1,497,590	182,000	230,859	2,520,811	7,542,020
35	Kilokot	123	780,000	150,000	60,000	10,000	145,364	1,145,364
36	Mitrovicë veriore	857	2,920,000	446,799	46,000	185,000	1,765,185	5,362,984
37	Partesh	144	895,000	150,000	40,000	10,000	34,456	1,129,456
38	Ranilloj	189	1,125,600	210,000	45,000	70,000	118,821	1,569,421
	Gjithsej	44,404	282,707,782	87,976,834	12,185,356	19,839,410	164,820,000	567,529,382

Tabela 2: Struktura e shpenzimeve për vitin 2023

Nr.	Komunat	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej 2023
1	Deçan	5,726,832	1,750,840	160,028	173,392	3,440,584	11,251,676
2	Dragash	4,854,975	1,098,320	133,357	292,599	3,409,871	9,789,123
3	Ferizaj	16,040,327	5,712,779	744,424	1,044,446	12,277,640	35,819,615
4	Fushë Kosovë	5,316,450	1,963,130	266,714	493,084	4,137,105	12,176,483
5	Gjakovë	14,502,150	3,682,772	593,643	650,763	9,791,873	29,221,200
6	Gjilan	16,280,137	4,884,925	591,694	1,051,191	7,947,876	30,755,822
7	Gilgoc	8,743,500	2,169,776	306,216	455,155	4,946,011	16,620,657
8	Hani i Elezit	1,764,863	398,800	69,448	86,696	584,048	2,903,855
9	Istog	6,543,555	1,646,921	207,216	335,947	3,446,871	12,180,510
10	Junik	1,160,384	209,518	37,135	54,185	272,268	1,733,490
11	Kaçanik	5,316,193	939,640	226,707	325,110	2,844,485	9,652,135
12	Kamenicë	7,580,125	1,673,000	217,269	371,710	1,780,098	11,622,202
13	Klinë	6,493,193	1,351,526	171,312	379,296	3,676,638	12,071,965
14	Leposaviq	2,375,461	429,116	65,653	102,952	1,838,324	4,811,505
15	Lipjan	9,935,430	2,064,387	338,521	830,115	5,249,442	18,417,896
16	Mafishevë	8,634,601	1,787,203	466,749	541,851	5,210,354	16,640,758
17	Mamushë	1,166,498	337,865	31,800	43,348	302,441	1,881,953
18	Mitrovicë	12,544,769	3,441,514	500,609	689,776	5,391,880	22,568,549
19	Novobërdë	2,133,288	322,980	71,808	57,328	464,119	3,049,523
20	Obiliq	4,371,750	1,331,497	324,852	921,146	5,202,280	12,151,525
21	Pejë	14,961,779	3,822,938	767,781	575,463	10,662,725	30,790,686
22	Podujevë	12,532,350	2,738,050	430,845	1,040,354	8,047,162	24,788,761
23	Prishtinë	31,456,500	21,903,297	2,256,807	5,186,829	33,974,817	94,778,250
24	Prizren	21,456,750	8,937,978	1,098,859	2,037,359	18,334,127	51,865,073
25	Rahovec	7,912,208	1,792,648	276,972	390,133	5,441,320	15,813,281
26	Shtërpçë	2,502,450	485,531	84,759	48,767	926,584	4,048,090
27	Shtime	4,427,613	1,033,954	215,423	162,555	2,250,222	8,089,766
28	Skenderaj	8,391,750	1,756,485	205,164	791,102	4,075,510	15,220,012
29	Suharekë	8,654,825	2,531,405	395,967	531,014	5,865,276	17,978,486
30	Viti	7,656,397	2,162,237	328,263	390,133	3,184,248	13,721,277
31	Vushitri	10,773,600	3,387,164	439,052	712,577	5,501,495	20,813,887
32	Zubin Potok	1,537,650	300,669	51,291	98,730	656,788	2,645,128
33	Zveçan	1,497,450	315,196	41,033	86,696	476,663	2,417,038
34	Gracanicë	3,126,314	1,547,350	186,700	250,182	2,713,697	7,824,242
35	Kllokot	783,900	154,984	61,549	10,837	186,708	1,197,978
36	Mitrovicë veriore	2,934,600	461,645	47,188	200,485	1,919,909	5,563,827
37	Partesh	899,475	154,984	41,033	10,837	72,785	1,179,114
38	Ranillug	1,131,228	216,978	46,162	75,859	171,111	1,641,338
Gjithsej		284,121,321	90,900,000	12,500,000	21,500,000	186,675,356	595,696,677

Tabela 3: Struktura e shpenzimeve për vitin 2024

Nr.	Komunat	Paga dhe shëtesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej 2024
1	Deçan	5,755,466	1,772,027	166,429	185,489	3,914,413	11,793,824
2	Dragash	4,879,250	1,111,611	138,691	313,013	3,824,604	10,267,169
3	Ferizaj	16,120,529	5,781,910	774,201	1,117,314	13,760,121	37,554,075
4	Fushë Kosovë	5,343,032	1,986,887	277,382	527,485	4,613,853	12,748,639
5	Gjakovë	14,574,661	3,727,338	617,389	696,165	11,216,786	30,832,338
6	Gjilan	16,361,538	4,944,038	615,362	1,124,529	9,197,064	32,242,531
7	Glllogoc	8,787,218	2,196,033	318,465	486,910	5,646,237	17,434,862
8	Hani i Elezit	1,773,688	403,626	72,226	92,745	697,114	3,039,398
9	Istog	6,576,273	1,666,850	215,505	359,386	3,949,065	12,767,078
10	Junik	1,166,186	212,053	38,620	57,965	337,245	1,812,070
11	Kaçanik	5,342,774	951,011	235,775	347,793	3,245,128	10,122,480
12	Kamenicë	7,618,026	1,693,246	225,960	397,643	2,249,992	12,184,866
13	Klinë	6,525,659	1,367,882	178,165	405,758	4,173,052	12,650,516
14	Leposaviq	2,387,339	434,308	68,279	110,134	2,040,796	5,040,855
15	Lipjan	9,985,107	2,089,368	352,062	888,030	5,996,502	19,311,070
16	Malishevë	8,677,774	1,808,830	485,419	579,654	5,896,728	17,448,406
17	Mamushë	1,172,331	341,954	33,072	46,372	374,290	1,968,019
18	Mitrovicë	12,607,493	3,483,161	520,633	737,900	6,489,221	23,838,408
19	Novobërdë	2,143,955	326,889	74,680	61,327	577,093	3,183,944
20	Obiliq	4,393,609	1,347,610	337,846	985,412	5,430,104	12,494,581
21	Pejë	15,036,588	3,869,200	798,492	615,611	12,151,286	32,471,177
22	Podujevë	12,595,012	2,771,184	448,079	1,112,936	9,062,589	25,989,800
23	Prishtinë	31,613,783	22,168,354	2,347,080	5,548,701	37,477,643	99,155,560
24	Prizren	21,564,034	9,046,138	1,142,813	2,179,500	20,414,992	54,347,478
25	Rahovec	7,951,769	1,814,341	288,051	417,351	6,296,418	16,767,931
26	Shtërpçë	2,514,962	491,406	88,149	52,169	1,070,366	4,217,052
27	Shtime	4,449,751	1,046,466	224,039	173,896	2,579,558	8,473,711
28	Skenderaj	8,433,709	1,777,741	213,371	846,295	4,671,353	15,942,469
29	Suharekë	8,698,099	2,562,038	411,806	568,061	6,616,379	18,856,383
30	Viti	7,694,679	2,188,403	341,393	417,351	3,751,332	14,393,158
31	Vushtrri	10,827,468	3,428,152	456,614	762,292	6,343,389	21,817,914
32	Zubin Potok	1,545,338	304,307	53,343	105,618	759,679	2,768,285
33	Zveçan	1,504,937	319,010	42,674	92,745	569,598	2,528,964
34	Gracanice	3,141,945	1,566,075	194,167	267,637	2,948,996	8,118,820
35	Klllokot	787,820	156,859	64,011	11,593	229,156	1,249,439
36	Mitrovicë veriore	2,949,273	467,231	49,075	214,472	2,282,122	5,962,173
37	Partesh	903,972	156,859	42,674	11,593	115,544	1,230,643
38	Ranillug	1,136,884	219,603	48,008	81,152	229,429	1,715,076
Gjithsej		285,541,928	92,000,000	13,000,000	23,000,000	211,199,236	624,741,163

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT- KOMUNA JUNIK

Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2020/2021, dhe përgadtjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022

Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport edhe përkundër gjendjes së krijuar të pandemisë Covid 19, ka përfunduar me sukses vitin shkollor 2020/2021. Andaj duke marr parasysh vështirësitë e cekura më lartë me angazhimin e Drejtorisë, menaxhmentit të dy shkollave dhe stafit arsimor i gjithë procesi mësimor është realizuar sipas kalendarit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

- Me 04.06.2021 ka përfunduar viti mësimor për klasat e 12 në gjimnazin Kuvendi i Junikut.
- Përfundimi i vitit mësimor për klasat e 0-1 deri në 8 ka përfunduar me datën 02 korrik 2021.
- Me datën 21.06.2021 ka përfunduar viti mësimor për klasat 9, 10 dhe të 11.
- Testi shtetëror i Maturës 2021 pran Gjimnazit "Kuvendi i Junikut" është kryer me sukses, duke u respektuar masat e institutit kombëtar të shëndetësisë, pas marrjes së rezultateve nga Komisioni për vlerësim dhe Standarde i MASHT-it, është konstatuar se testin e kalojnë 90 % Maurantet e gjimnazit "Kuvendi i Junikut" në Junik (prej 64 maturanëve nga drejtimi shkencat natyore, shoqërore dhe drejtimi i medicinës testin e kalojnë 56 nxënës dhe testin nuk e kalojnë 8 nxënës).
- Testi i arritshmerisë për klasat e nënta është mbajtur me 21 maj, ne përputhje me rekomandimet e institutit kombëtar të shëndetësisë, bazuar në rezultatet e arritura nga komisioni për vlerësim nga MASHT-i, niveli i kalueshmërisë ishte 98%.
- Gjithashtu janë organizuar mbrëmjet e maturës dhe semimaturës si dhe për gjeneratën e Covit – 19, ku Komuna e Junikut ka mbuluar shpenzimet e mbrëmjes maturës për këtë gjeneratë.
- Është bërë furnizimi me lende djegëse për ngrohje (dru) për shkollat e komunës së Junikut (150 metra ne shkollën fillore dhe 80 m në gjimnaz, si dhe sharritja).
- Janë dorëzuar kërkesat me kohë për furnizim me tekste shkollore për nxënësit të shkollës fillore nga klasa para fillor e gjerë në klasën e nënte, kërkesa është aprovuar nga MASHT-i.
- Me kohë është bërë regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të shkollës fillore dhe në shkollën e mesme, sipas afateve ligjor, ku në gjimnaz kemi pasur një numër të shtuar të nxënësve në klasat e dhjeta, në drejtimet Shkencat natyrore , shkencat shoqërore- gjuhësore, si dhe në drejtimin e mjekësisë se përgjithshme, që është paralele ne kuadër te shkollës se mesme te mjekësisë Hysni Zajmi të Gjakovës.
- Shkollat i kemi furnizuar me material hargjues për mbajtjen e higjienës si dhe me materiale administrativ për zyre për shkollat e Komunës së Junikut, punëtorët teknik janë duke punuar në lokalet e veta për të arritur që me kohë të përgatisin objektet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.

Shtojca: 01

Suksesi i nxënësve për vitin shkollor, 2020/21, Arsimi i mesëm i ulët (1-5)

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv												Gjithsej me nota të pamjaftueshme				Numri i mungesave		
			Sh. mirë				Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Gjithsej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar			Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	
			Nr		%		Nr		%		Nr		%		Nr	%	Nr				%
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%									
1	3	60	35	58.33	12	0.2	11	18.33	2	0.33	60	%	/				156	16	172		
2	3	47	23	48.93	11	23.4	5	10.6	2	4.25	47	%	/				202	5	207		
3	3	65	28	43.07	12	18.46	17	26.15	8	12.3	65	%	/				286	44	330		
4	3	51	29	56.86	15	29.41	6	11.76	1	0.17	51	%	/				653	/	653		
5	3	51	29	56.86	9	17.64	8	15.68	4	0.78	51	%					237	175	412		
GJ	15	274	144	52.25	59	21.15	47	17.15	17	6.2	274	%					1534	240	1774		

Suksesi i nxënëseve për vitin shkollor, 2020/21, Arsimi i mesëm i ulët (6-9)

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv												Suksesi i pamjaftueshëm								Numri i mungesave		
			Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme		Gjithsej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej		
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%					
6	3	63	20	31.74	26	41.69	11	17.46	5	7.93	63	%									847	28	875		
7	3	56	13	23.32	14	25	16	28.57	13	23.21	56	%									541	88	629		
8	3	44	17	38.63	17	38.63	5	11.36	5	11.36	44	%									453	124	577		
9	3	58	18	31.03	14	24.13	21	36.2	5	8.62	58	%									530	98	628		
GJ	12	221	68	30.76	71	32.12	53	23.98	28	12.66	221	%									2371	338	2709		

Shtojca: 03

Suksesi i nxënësve për vitin shkollor , 2020/21, Arsimi i mesëm i lartë (10-12)

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv												Suksesi i pamjaftueshëm						Numri i mungesave		
			Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 notë të pamjaftueshme		Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme		Gjithsej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
10	3	56	12	21.12	16	28.37	10	17.85	38	67.85	5	8.92	4	7.14	7	12.5	16	28.57	2	3.57	436	27	463
11	3	72	23	31.94	15	20.83	9	12.25	47	65.27	3	4.16	3	4.16	17	23.61	23	31.94	2	2.77	327	199	526
12	3	65	15	23.07	14	21.53	6	9.23	37	56.92	7	10.76	3	4.61	16	24.61	26	40	2	3.07	421	248	669
GJ	9	193	50	25.90	45	23.31	25	12.95	122	63.21	15	7.77	10	5.18	40	20.72	65	33.67	6	3.10	1184	474	1658



2-155/7082
2
17.08.2021



RËPUBLIKA E KOSOVËS – RËPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	17.08.2021
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Muharrem Krasniqi-Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Agron Kuçi – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Krasniqi-drejtore për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë



Bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 17 pika i të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), nenit 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit. Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës Junikut ju bëjmë këtë:

KËRKESE

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal marrja e vendimit për Plotësim ndryshimin e vendimit për fillimin e procedurave për Hartimin e Programit Trevjeçar Komunal për banim 2021-2023.

Ju faleminderit për bashkëpunim!